



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1051, datë 17.11.2009

Për

**revokimin e VKD Nr. 588 date 26.12.2008, Autorizimit Individual te sipërmarrësit
“Arlindi-06” shpk**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), ne mbledhjen e datës 17.11.2009, sipas procedurës se përcaktuar ne nenin 7 e ne vijim te Rregullores së Brendshme (Rregullorja), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, date 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe ne fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, date 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, mori ne shqyrtim:

- *Propozimin e Drejtorisë se Licensimit për miratimin e njoftimi i sipërmarrësit “Arlindi-06” shpk për heqje dore nga përdorimi i frekuencave te një lidhje fikse.*

BAZA LIGJORE :

- Ligji Nr. 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, neni 8 – germa j) dhe neni 76 pika 1;
- Rregullorja për Autorizimin Individual miratuar me VKD Nr. 510 date 04.11.2008. neni , pika 1.
- Rregullorja e brendshme e AKEP miratuar me Vendim te Këshillit Drejtues Nr. 170 date 24.04.2004, e ndryshuar - neni 21, pika 17.
- Neni 121 e ne vijim te ligjit nr. 8485, date 12. 05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485);

Nga shqyrtimi i materialit te paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore te sipërcituar,

VËREHET SE :

1. Sipërmarrësi “Arlindi-06” shpk, është i regjistruar ne regjistrin e sipërmarrësve qe ofrojnë rrjete dhe shërbime te komunikimeve elektronike.
2. Me Vendimin Nr. 588, date 26.12.2008, Këshillit Drejtues i AKEP ka vendosur te pajise sipërmarrësin “Arlindi - 06” shpk me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave ne brezin 23 GHz për lidhjen fikse Suç-Burrel dhe specifikimet teknike te kësaj lidhje

përshkruhen ne Aneksin 1 bashkëlidhur vendimit. Ky Autorizim ishte përcaktuar ne vendim te ishte i vlefshëm deri me 20.03.2017.

3. Me shkresën nr.853/40 prot. date 10.03.2009, ky sipërmarrës deklaroi se nuk ka ne përdorim asnjë lloj frekuence dhe tani rrjeti i tij është i ndërtuar me kablo ajrore.
4. Neni 76 i ligjit nr. 9918 parashikon revokimin e autorizimit individual nga AKEP me kërkesën e palës se cilës i është lëshuar autorizimi.
5. Pika 1 e nenit 8 te Rregullores parashikon revokimin e autorizimit individual me kërkesën e te autorizuarit.
6. Neni 121 e ne vijim i ligjit nr. 8485 parashikon shfuqizimin/revokimin e akteve administrative individuale nga ana e organit administrativ kompetent.

Për sa me sipër, duke qene se:

- vete pala se cilës i është lëshuar Autorizimi individual, sipërmarrësi “Arlindi-06” shpk ka paraqitur kërkesën ne AKEP për heqjen dore nga e drejta e përdorimit te frekuencave te përcaktuara ne Autorizimin individual;
- VKD nr. 588, date 26. 12. 2008 është një akt administrativ individual brenda fushës se zbatimit te ligjit nr. 8485,

Këshilli Drejtues, bazuar ne:

- piken 1 te nenit 76 te ligjit nr. 9918;
- piken 1 te nenit 8 te Rregullores;
- nenin 124, 125 dhe 126 te ligjit nr. 9918,

ne mbështetje ne pikës 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës se sipërmarrësit “Arlindi-06” shpk, revokimin e VKD Nr. 588 date 26.12.2008 dhe konkretisht shfuqizimin e pikës 4 se bashku me Aneksin 1 te këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit për njoftimin e sipërmarrësit, Drejtoria Teknike për përditësimin e te dhënave për frekuencat e brezit 23 GHz për shkak te këtij vendimi dhe te gjitha Drejtoritë sipas objektit te tyre te zbatojnë efektet qe sjell ky vendim.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES
Ilir SHEHU

Anëtare te Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**

